



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:244324

Datë: 04.05.2022

Numri i dokumentit: 02977204

P.nr.564/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Diana Sina, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale, kundër të akuzuarit, L.A., nga Gj., për shkak të veprës penale, dhunë në familje nga neni 248 paragrafi 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, PP/II.nr.1491/2021, të datës 29.10.2021, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datën 06.04.2022, në prani të Prokurores së shtetit Mone Sylja, të akuzuarit L.A., mbrojtëses së tij, avokate Shpresa Bakija, të dëmtuarës G.M. dhe mbrojtëses së viktimave, F.B.- Q., me të njëjtën datë mori dhe shpalli, ndërsa me datën 20.04.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari L.A. nga i ati H., e ëma H. e gjinisë D., i lindur me..., në fshatin Rr., Komuna Gjakovë, banon në rr... Gj., i martuar- atë i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, punëtor, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal..

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse: me datë 20.05.2021 rreth orës 18:00, në rrugën “Memë Lleshi”, Komuna e Gjakovës, më saktësishtë në shtëpinë e tyre, i dyshuari shkakton dhunë në familje, respektivisht keqtrajtim fizik me qëllim të cenimit të dinjitetit bashkëshortes së tij – të dëmtuarës G.M., në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme në mes vete, ditën kritike i pandehuri kërkon unazën e të dëmtuarës dhe pasi e dëmtuara refuzon që ti’a jep unazën e saj, i pandehuri me përdorim të forcës ia merr unazën dhe pastaj e sulmon duke e goditur disa herë me duar në disa pjesë të trupit, me çka të dëmtuarës i shkakton dhimbje fizike dhe cënim të dinjitetit të saj.

- Me çka ka kryer veprën penale, Dhuna në familje nga neni 248 paragrafitë 1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17 par. 1, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 76 par.2, nënpar. 2.4, nenit 248 par. 1 të KPRK-së, të akuzuarin:

G J Y K O N

DËNIM ME GJOBË në shumë prej 200.00.-€ (dyqind euro), si dhe
DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditë.

Me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit konform nenit 44 të KPRK-së, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, i zëvendësohet me:

DËNIM ME GJOBË në shumë prej 600.00.-€ (gjashtëqind) euro, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Për veprën penale, për të cilën është shpallur fajtor, Gjykata në kuptim të nenit 76 par. 2 nënpar. 2.4 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM UNIK

DENIM ME GJOBË -në shumë prej **800.00.-€ (tetëqind) euro**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-së, dënimi me gjobë do ta zëvendësojë me dënim burgu në kohëzgjatje prej **40 (dyzetë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00.-€ (njëzet) euro të gjobës**.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej **20.00 euro**, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej **30.00 euro**, e të gjitha këto në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

E dëmtuara G.M. nga Gj., rruga... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1491/2021 të datës 29.10.2021, kundër të akuzuarit – L.A., për shkak të veprës penale, Dhuna në familje nga neni 248 paragrafitë 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që i njëjtit të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari L.A. në shqyrtimin fillestar të mbajtur me 06.04.2022, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij avokaten Shpresa Bakija, deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, për të cilën veprë jam penduar pa masë duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë të njëjtën, menjëherë pas rastit i kam kërkuar falje bashkëshortes sime, e cila ma ka falur gabimin, tani përsëri jetojmë së bashku në të njëjtën shtëpi, kemi dy fëmijë, prej këtij rasti nuk kemi pasur asnjë mosmarrëveshje në mesë veti, edhe tani në prezencë të gjykatës shfrytëzoi rastin dhe i kërkoi falje këtu bashkëshortes sime si palë e dëmtuar, duke i premtuar se një veprim të tillë nuk do ta përsërisë si dhe në të ardhmen do të jem bashkëshortë i kujdesshëm dhe baba i kujdesshëm i fëmijëve të mijë, shton se jam në gjendje të dobët materiale, jam punëtor, mbajtës i vetëm i familjes, andaj i propozoi gjykatës që të ketë parasysh këto rrethana dhe të më shqiptoi në dënim më të butë.

Mbrojtësja e të akuzuarit avokatja Shpresa Bakija, pas deklarimit të akuzuarit lidhur me pranimin e fajsisë deklaroi, se nuk e kundërshtoi pranimin e fajsisë të bërë nga ana e të mbrojturit tim, me të mbrojturin tim jam konsultuar paraprakisht për favoret dhe benefitet e pranimit të fajsisë, këtë pranim të fajsisë e bënë me vullnet të lirë, pa presion, i propozoi gjykatës që me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, të ketë parasysh pranimin e fajsisë, kërkim falje publike të dëmtuarës, pendimin e thellë të tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën e tillë penale, gjë të cilën edhe është argumentuar se pas këtij rasti përsëri jetojnë në të njëjtën shtëpi, dhe nuk kanë pasur asnjë mosmarrëveshje, kanë dy fëmijë për të cilët kujdeset këtu i akuzuari, është mbajtës i vetëm i familjes, si dhe për herë të parë paraqitet në gjykatë për një veprë të tillë penale, andaj i propozoi gjykatës që të njëjtit ti shqiptoi një dënim sa më të butë dhe nëse gjykata gjen elementet që të njëjtin të dënoi me dënim burgu deri në 6 muaj, të njëjtit të i zëvendësoi me dënim me gjobë, me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit.

E dëmtuara G.M. deklaroi, se nuk e kundërshton pranimin e fajsisë të bërë nga ana e të akuzuarit, unë si palë e dëmtuar bashkëshortit tim këtu të akuzuarit ia kam falur gabimin, gabimin ia kam falur që në deklaratën që kam dhënë në stacionin policor, sepse kjo mosmarrëveshje ka qenë momentale, andaj i propozoi gjykatës që të njëjtit ti shqiptoi një dënim sa më të butë, sepse ai është mbajtës i vetëm i familjes, tani është shumë i kujdesshëm, kujdeset për mua dhe për fëmijët tanë dhe prej atij momentit nuk e ka përsëritur veprën penale.

Mbrojtësja e viktimave F.B. -Q. deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajsisë të bërë nga ana e të akuzuarit, si dhe e mbështes deklaratën e të dëmtuarës G.M.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit Prokuroria e Shtetit Mone Sylja deklaroi se, nuk e kundërshton pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit pasi që i njëjti pranimin e fajsisë e bën me vullnet të plotë, pa presion i njëjti paraprakisht ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e mbrojtësit të tij për benefitet dhe pasojat e pranimit të fajsisë, si dhe pranimi i fajsisë ka mbështetur në provat dhe faktet që përmban aktakuza, i propozoi gjykatës së me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me ligj.

2. Vlerësimi i pranimit të fajsisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtarja e vetme gjykyese pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimi i fajsisë nga i akuzuari L.A., për shkak të veprës penale „Dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së, pranimi është bërë në kuptim të dispozitave të nenit 248 të KPP-së, i akuzuari i kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij, pranimi behet vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështet ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendjet faktike të vërtetuara

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtarja e vetme gjykyese ka vërtetuar këto gjendje faktike se: I akuzuari L.A. nga Gj., ka kryer veprën penale, Dhuna në familje nga neni 248 paragrafitë 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 248 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Dhuna në familje kryen: *“Kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tre) vjet”*.

5. Vendimet e gjyqtarës së vetme gjykuese

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij, si dhe pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpallë fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: gjendjen e tij të dobët ekonomike, është baba i dy fëmijëve, mbajtës i vetëm i familjes, pranimin e fajësisë, pendimin e tij të thellë për veprën e kryer si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepër penale, sjelljet e tij tejet korrekte në gjykim, kërkim falje publike të dëmtuarës-bashkëshortes së tij, për veprën që e ka kryer, pajtueshmërinë e tyre dhe vazhdimin e jetesës së bashku, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh: peshën e veprës penale, vepra është kryer brenda marrëdhënies familjare, është i njohur për policinë, prokurorinë dhe për Gjykatën si recidivist i veprave të natyrave tjera penale, duke marr parasysh këto rrethana, Gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij do të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par.1. të KPP-së , si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036.për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
-Departamenti i përgjithshëm-
P.nr.564/21 më datë 06.04.2022

Sekretarja Juridike,
Lamije Kuqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Diana Sina

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2021:244324
Datë: 04.05.2022
Numri i dokumentit: 02977204